



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 451 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 70 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Ekspedita përnjohëse në prapatokën e Dyrrachiumit"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtuese Dr. Brikena Shkodra Rrugia,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Ekspedita përnjohëse në prapatokën e Dyrrachiumit"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtuese Dr. Brikena Shkodra Rrugia, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kërkimi parashikohet të përqëndrohet në dy drejtime të territorit përreth Durrësit: Lindor, përgjatë shtrirjes së ujësjellësit; Juglindor, përgjatë shtrirjes së rrugës Egnatia.
- II. Periudha kohore e kryerjes së kërkimit do të jetë 14-23 gusht 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO